

IPA 2010/271-284

Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit: Forcimi i Rrjetit të Prokurorëve

Titulli i projektit	Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit: Forcimi i Rrjetit të Prokurorëve
Fusha e projektit	Shqipëria, Bosnia dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, Serbi
Buxheti	5.263.158
Financimi	BE (MB IPA 2010) 5 Mio €; Gjermani (BMZ) 263.158 €
Zbatimi i projektit	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH; Center for International Legal Cooperation (CILC)
Kohëzgjatja	15 Nëntor 2011 – 14 Nëntor 2013

PARATHËNIE

Në Shkup më 30 Mars 2005, u firmos një Marrëveshje Mirëkuptimi (MoU) midis vendeve të Ballkanit Perëndimor, për bashkëpunimin dhe krijimin e rrjeteve të bashkëpunimit në hetime në luftën kundër krimit të organizuar. Marrëveshja e Mirëkuptimit, që krijonte një Rrjet Prokurorësh, u rishikua në Romë në Janar të vitit 2010. Përmes këtij Rrjeti të Prokurorëve, një kornizë ligjore u vendos për të bashkëpunuar ngushtësisht në fushën e hetimit dhe ndjekjes penale të autorëve të krimit të organizuar, grupeve kriminale dhe bashkëpunimeve kriminale. Bashkëpunimi bazohet në shkëmbimin e eksperiencave, dokumentave dhe të dhënave lidhur me të gjitha format e krimit të organizuar në juridiksionin e shteteve nënshkruese, veçanërisht në rastet e krimeve të kryera në territoret e tyre dhe/ose duke përfshirë shtetasit e tyre ose të huajë, si subjekte aktivë ose pasivë të veprave penale. Bashkëpunimi gjithashtu përfshin kërkesat për ndihmë ligjore reciproke, zhvillimi i mekanizmave të përbashkëta hetimore dhe strategjitë kundër krimit të organizuar, si dhe organizimin e takimeve rajonale të rregullta, për të ndarë eksperiencat dhe praktikat më të mira.

PËRSHKRIMI

Projekti IPA "Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit: Forcimi i Rrjetit të Prokurorëve" do të adresohet, Zyrrave të Prokurorive të Përgjithshme të shteteve Përfituese dhe Pikave Kombëtare të Kontaktit të Rrjetit të Prokurorëve të Ballkanit Perëndimor, po ashtu edhe të Kosovës. Ekspertë afatgjatë do të vendosen në rajon (prokurorë të atashuar, të Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian) do të bashkëpunojnë ngushtësisht me Zyrrat e Prokurorive të Përgjithshme në vendet e Ballkanit Perëndimor, përgjegjëse për bashkëpunimin ndërkombëtar që lidhet me hetimet dhe ndjekjet penale të rasteve të krimeve të organizuar, rasteve të lidhura me krimet në fushën ekonomike dhe financiare, korrupsionin dhe terrorizmin. Vendosja e ekspertëve afatgjatë në institucionet përkatëse do të realizohet sipas kushteve, kërkesave dhe nevojave të shteteve Përfituese.

Prokurorët e atashuar nga Shtetet Anëtare të BE, do të japin mbështetjen e tyre këshillimore, njohuri dhe ekspertizë në veprimtarinë e përditshme të Prokurorive të Përgjithshme në Shtetet Përfituese, në mënyrë që të kontribuojnë në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtarë (themelimi i grupeve të përbashkëta hetimore, ndihma juridike reciproke, transferimi i procedimeve, kërkesat për ekstradim) dhe në përmirësimin e standarteve profesionale të Zyrrave të Prokurorive të Përgjithshme.



Për të bërë të mundur këtë detyrë, si dhe për të mbështetur dhe promovuar bashkëpunimin ndërkufitar në hetimin dhe ndjekjen penale (p.sh përmes themelimit të grupeve hetimore të përbashkëta, për të bërë të mundur avancimin e kërkesave për ndihmë juridike reciproke, përmes transferimit të procedimeve, përmes dëgjimeve të video konferencave, etj.), prokurorët e atashuar të BE-së, mund të kërkojnë informacion relevant dhe të nevojshëm, lidhur me çështjet ndërkufitare në hetim, veçanërisht mbi krimin e organizuar dhe korrupsioni. Ky informacion mund të jepet bazuar dhe në përputhje me legjislacionin ekzistues, përfshirë këtu marrëveshjet dypalëshe ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian dhe shteteve përfituese, që rregullojnë shkëmbimin e informacionit në fushën e bashkëpunimit gjyqësor, ku duhet gjithashtu të merren në konsideratë dispozitat që rregullojnë mbrojtjen e të dhënave.

Për të përmbushur nevojat e Përfituesve, ekspertët afatgjatë do të krijojnë grupe pune ekspertësh rajonalë, mbi tema specifike dhe mund të kërkojnë ekspertizë nga një ekip ekspertësh afatshkurtër që mbështesin identifikimin e problematikave edhe zbatimin e zgjidhjeve të mundshme.

Projekti drejtohet nga Ekipi Menaxhes, i kryesuar nga një Drejtues i Lartë Projekti dhe i mbështetur nga strukturat menaxhuese dhe administrative të GIZ-s në rajon, dhe CILC në Hagë.

Bashkëpunim i ngushtë është arritur me Grupin e Prokurorëve Këshilltar të Europës Juglindore (SEEPAG), Njësitë Koordinuese për Zbatimin e Legjislacionit Ndërkombëtar (ILECUs), Mbrojtjen e Dëshmitarëve në Luftën Kundër Krimeve të Rënda dhe Terrorizmit (WINPRO) dhe projekte dhe struktura të tjera në rajon dhe në nivel ndërkombëtar, veçanërisht në Rrjetin Evropian Gjyqësor dhe EUROJUST-in.

QËLLIMI, REZULTATET E PRITSHME DHE VEPRIMTARITË

Qëllimi i Përgjithshëm	Të kontribuojmë në përmirësimin e bashkëpunimit gjyqësor ndërkufitar dhe ndërkombëtar, tek Përfituesit, në hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve ndërkufitare, veçanërisht lidhur me krimin e organizuar dhe korrupsionin.
Qëllimi Specifik	Të forcojmë kapacitetet operuese dhe aftësitë e zyrave të prokurorive të Përgjithshme në vendet përfituese, në hetimin dhe ndjekjen penale të krimit të organizuar, çështjet e lidhura me krimin ekonomik, financiar dhe korrupsionin.
REZULTATI 1.1.	Prokurorët e Shteteve Anëtare të BE-së, të atashuar pranë Zyrave të prokurorive të Përgjithshme, si ekspertë afatgjatë, përgjegjës tek Përfituesit për hetimin dhe ndjekjen penale të krimit të organizuar, çështjet e lidhura me krimin ekonomik dhe financiar, korrupsionin dhe terrorizmin.
REZULTATI 1.2.	Përmirësimi i kapaciteteve të zyrave të prokurorive të përgjithshme në vendet përfituese, në hetimin dhe ndjekjen penale të krimit të organizuar, si dhe çështjet e lidhura me krimin ekonomik dhe financiar, korrupsionin dhe terrorizmin.
REZULTATI 2	Lehtësimi dhe nxitja e komunikimit direkt dhe e aftësive bashkëpunuese të Zyrave të Prokurorive të Përgjithshme në shtetet Përfituese, për të marrë, dhënë dhe përdorur efektivisht ndihmën ligjore reciproke (përfshirë, masat hetimore të veçanta, grupet hetimore të përbashkëta dhe/ose procedimet gjyqësore), për të vazhduar me procedurat e ekstradimit dhe përkatësinë e fillimit dhe transferimit të procedimeve në çështjet penale.
REZULTATI 3.1.	Nxitja e bashkëpunimit të Rrjetit të Prokurorive me EUROJUST, Rrjetin Gjyqësor Evropian, Qendra SECI/SELEC, SEEPAG, EUROPOL, OLAF, dhe ILECU dhe WINPRO

REZULTATI 3.2.

Rritja e ndjenjës së pronësisë dhe institucionalizimi i Rrjetit të Prokurorëve.

KONTAKTI

Për informacione shtesë, ju lutem kontaktoni:

Dr. Thomas Meyer
Projekt Menaxheri i Ballkanit Perëndimor
IPA 2010 "Fight against organised crime and
corruption: Strengthening the Prosecutors'
Network"

Eric Vincken
Projekt Menaxheri Ndërkombëtar
IPA 2010 "Fight against organised crime and
corruption: Strengthening the Prosecutors'
Network"

Open Regional Fund for Southeast Europe – Legal
Reform
Deutsche Gesellschaft für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
Zmaje od Bosne 7 – 7a
71000 Sarajevo,
Bosnia and Herzegovina

Center for International Legal Cooperation
Koninginnegracht 7,
2514 AA Den Haag
The Netherlands

Tel. +387 33 957 500
Fax +387 33 957 535
Mail thomas.meyer@giz.de

Tel. +31 (0)70 311 7250
Fax. +31 (0)70 311 7260
Mail vincken@cilc.nl



This project is funded by
the European Union